

# AKT THEMELIMI I SHOQËRISË ME PËRGJËGJËSI TË KUFIZUAR

## “JU&CONSULTING” SHPK

Në Tiranë, sot më datë 10.01.2024, ne të poshtëshënuarit:

**1. Tatjana Xhafa** i datëlindjes 24.03.1967, lindur ne Tirane dhe banues në Tiranë, identifikuar me dokument identifikimi: Letërnjoftim ID, me numër personal **G75324045N**, dhe

**2. Jurgen Xhafa** e datëlindjes 25.03.1996, lindur ne Tirane dhe banues në Tiranë, identifikuar me dokument identifikimi: Letërnjoftim ID, me numër personal **J60325056C**

me cilësinë e “ortakëve themelues” deklarojmë se me vullnet të lirë të plotë, mbështetur në ligjin Nr.9901 datë 14.04.2008, “ Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar, ligjin Nr. 9723, datë 3.5.2007 “ Për Regjistrimin e Biznesit ‘, i ndryshuar, krijojmë shoqërinë tregtare me përgjegjësi të kufizuar, e emertuar “**JU&CONSULTIN**” SHPK.

### Neni 1 Emri, Forma

Shoqëria do të ketë emrin “**JU&CONSULTING**” SHPK dhe formë ligjore: “Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar” (më poshtë e quajtur “Shoqëria: “**JU&CONSULTING**” SHPK

### Neni 2 Personaliteti juridik

Shoqëria fiton personalitetin juridik, pasi të jetë regjistruar në QKB, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

### Neni 3 Selia

Selia e Shoqerise “**JU&CONSULTING**” SHPK do te jete: Zona kadastrale 3292, Rruga” Rrapo Hekali”, Pallati Pira 1, Hyrja 18, Ap. 3, Tirane.

### Neni 4 Objekti i veprimtarisë

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë do të jetë: Sherbime te Konsulences Financiare, Ekonomike, Fiskale, Ligjore, sherbime te kontabilitetit, sherbime financiare, sherbime te auditimit kombetare. Pjemarrje dhe organizime te trajnimeve ne projekte te ndryshme, me karakter ekonomik, juridik, social-kulturor e tjera. Hartim, zbatim, monitorim, implementim i projekteve te ndyshme. Studime tregu te inputeve dhe interbrandeve. Sherbime te ndryshme ndermjtesimi e vleresimi. Konsulenca ne fushen e menaxhimit, te marketingut, marrdhenieve me publikun, lobimin per pale te treta sipas

Standarteve kombetare dhe nderkombetare (ISO e tjere) per te gjitha llojet e organizatave, shoqerive tregtare dhe institucionet publike, etj.

Neni 5  
Kohëzgjatja

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj me afat të pacaktuar dhe mund të shperbehet me vendim të ortakeve të saj në çdo kohë.

Neni 6  
Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i nënshkruar i shoqërisë është 100.000 (njëqind mijë) lekë, i ndarë në dy kuota, i cili zotërohet si më poshtë:

**1. Tatjana Xhafa** zotëron 1 kuota me vlerë 50.000 lekë, e cila përbën 50 % të kapitalit të shoqërisë.

**2. Jurgen Xhafa** zotëron 1 kuota me vlerë 50.000 lekë, e cila përbën 50% të kapitalit të shoqërisë.

Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta)

Ortakët nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkuara.

Neni 7  
Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit të saj në Qendren Kombetare të Biznesit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit".

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

Neni 8  
Organi Vendimmarrës



Asambleja e Ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë, për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.


Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

Neni 9

Administrimi

Administratorë të shoqërisë janë:

**1. Jurgen Xhafa** e datëlindjes 25.03.1996, lindur ne Tirane dhe banues në Tiranë, identifikuar me dokument identifikimi: Letërnjoftim ID, me numër personal **J60325056C**, i emëruar ne këtë detyrë për një afat 5 vjeçar me të drejtë ripëritje.

Specimeni i nenshkrimit te administratorit JURGEN XHAFJA 

Neni 10

Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë akt themelimi dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet ne kete akt themelimi, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 11

Dispozita perfundimtare





Ky akt themelimi u redaktua ne 4 kopje, në gjuhën shqipe, me përmbajtje dhe vlera te njëjta juridike.

Akti i mësipërm pasi miratohet në parim dhe nen per nen nga Ortakët themelues të shoqërisë tregtare: **“JU&CONSULTING” SHPK**, nënshkruhet në të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmen orgjinale.

Ngarkohet Tatjana Xhafa, te rregjistroj Shoqerine ne QKB.

Tiranë, më 10.01.2024.

### ORTAKËT THEMELUES

**TATJANA XHAFJA**

*Tatjana Xhafa*

*TX*

**JURGEN XHAFJA**

*Jurgen Xhafa*

*JX*

## STATUTI I SHOQËRISË “JU&CONSULTING” SHPK

### Neni 1

#### Emri, Forma

Shoqëria do të ketë emrin “**JU&CONSULTING**” SHPK dhe formë ligjore: “Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar” (me poshtë e quajtur: Shoqëria ( “**JU&CONSULTING**” SHPK)

### Neni 2

#### Selia

Selia e Shoqërisë “**JU&CONSULTING**” SHPK do të jetë: Zona kadastrale 3292, Rruga “ Rrapo Hekali”, Pallati Pira 1, Hyrja 18, Ap. 3, Tirane.

### Neni 3

#### Objekti i veprimtarisë

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë do të jetë: Sherbime të Konsulences Financiare, Ekonomike, Fiskale, Ligjore, sherbime të kontabilitetit, sherbime financiare, sherbime të auditimit kombëtarë. Pjemarrje dhe organizime të trajnimeve në projekte të ndryshme, me karakter ekonomik, juridik, social-kulturor e tjera. Hartim, zbatim, monitorim, implementim i projekteve të ndryshme. Studime tregu të inputeve dhe interbrandeve. Sherbime të ndryshme ndërmjetesimi e vlerësimi. Konsulencia në fushën e menaxhimit, të marketingut, marrdhenieve me publikun, lobimin për pale të treta sipas Standarteve kombëtare dhe ndërkombëtare (ISO e tjere) për të gjitha llojet e organizatave, shoqërive tregëtare dhe institucionet publike, etj.

### Neni 4

#### Kohëzgjatja

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në periudhë kohore pa afat, dhe mund të shpërbehet në çdo moment me vendim të ortakëve të saj.

### Neni 5

#### Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i nënshkruar i shoqërisë është 100.000 (njëqind mijë) lekë, i ndarë në dy kuota, i cili zotërohet si më poshtë:

1. **Tatjana Xhafa** zotëron 1 kuotë me vlerë 50.000 lekë, e cila përbën 50 % të kapitalit të shoqërisë.
2. **Jurgen Xhafa** zotëron 1 kuotë me vlerë 50.000 lekë, e cila përbën 50% të kapitalit të shoqërisë



Ortakët nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara

Neni 6  
Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit të saj në Qendren Kombëtare të Biznesit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit".

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

Neni 7  
Organi Vendimmarrës

Asambleja e Ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë, për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

Neni 8  
Mënyra e thirrjes

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1. të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë

Neni 9  
Kuorumi

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, sipas nenit 10 të Statutit, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare". Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Neni 10  
Marrja e vendimeve

Me përjashtim të rasteve kur statuti parashikon një shumicë më të lartë, asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të ortakëve pjesëmarrës, siç përcaktohet në paragrafin e parë të nenit 9 të këtij statuti, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë ligj ose në statut, për çështjet e tjera të renditura në nenin 7 të këtij Statuti, asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës.

Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë ligj, vlefshmëria e vendimeve, që përcaktojnë detyrime shtesë mbi ortakët, apo vendimet që kufizojnë të drejtat e tyre, të parashikuara në ligj ose në statut, kushtëzohet nga miratimi i ortakut përkatës.

Neni 11  
Administrimi

1. Administratorë të shoqërisë janë: **2.Jurgen Xhafa** e datëlindjes 25.03.1996, lindur ne Tirane dhe banues në Tiranë, identifikuar me dokument identifikimi: Letërnjoftim ID, me numër personal **J60325056C**, i emëruar ne këtë detyrë për një afat 5 vjeçar me të drejtë ripërritje.

Specimeni i nenshkrimit te administratorit

JURGEN XHAFJA 





Neni 12  
Kompetencat

Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecuresë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- ë) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Neni 13  
Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përfundimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 14  
Bilanci i shoqërisë dhe dividendët

Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit financiar, Mbledhja e Asamblesë, miraton bilancin e paraqitur nga Administratori. Mbledhja e Asamblesë së ortakëve vendos rreth shpërndarjes së dividendit, pasi të jenë zbritur humbjet e vitit të mëparshëm financiar, siç edhe parashikohet nga ligji.

Neni 15

Shoqëria priset:

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të asamblesë së përgjithshme;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;

d) me vendim të gjykatës;

Ne rastin e pikës b) Asambleja e Ortakëve merr vendim në të cilin parashikon menyren e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej saj emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë “ Shoqëri në likuidim e sipër “.

Neni 16

Likuiduesi merr përsipër të drejtat dhe detyrimet e administratorëve nga data e emërimit të tij. Nëse shoqëria emëron më shumë se një likuidues, përveçse kur akti i emërimit parashikon se ata veprojnë veçmas njëri-tjetrit, likuiduesit ushtrojnë bashkërisht të drejtat e detyrimet. Kufizimet e tagrave të likuiduesve u kundrejtohen të tretëve, në përputhje me përcaktimet e ligjit.

Neni 17

Riorganizimi (bashkimi, ndarja, shndërrimi

Riorganizimi i shoqërisë (bashkim, ndarje, shndërrim) do të kryhet në përputhje me dispozitat e ligjit 9901 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”

Neni 18

Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plote me këto statut dhe dispozitat e legjisllacionit shqiptar. Për sa nuk parashikohet në këto statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 19

Mosmarrëveshjet

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

Neni 20

Dispozita përfundimtare

Ky Statut u redaktua në gjuhën shqipe dhe nënshkruhet me vullnetin e tij të lire nga ortakët themelues.

Tiranë, më 10.01.2024.

**ORTAKËT THEMELUES**

**TATJANA XHAFJA**

Tatjana Xhafa  
07

**JURGEN XHAFJA**

Jurgen Xhafa  
JX